

ZHVILLIMI EKONOMIK ALTERNATIV NË ZONAT ME RISK TË LARTË TË VEPRIMEVE ILEGALE/INFORMALE SI MJBELLJA E KANABISIT NË GJIROKASTËR DHE DROPULL (CALT)

Konteksti

Bashkitë e Gjirokastrës dhe Dropullit kanë pasur rritje të kultivimit të kanabisit gjatë viteve të fundit. Për shkak të papunësisë së lartë, veçanërisht në zonat rurale të këtyre bashkive, shumë prej banorëve kanë nisur të kultivojnë kanabis për të siguruar të ardhura për familjeve të tyre. Për të luftuar këtë fenomen në këto dy bashki, projekti do të zbatojë aktivitete të cilat do të rrisin mundësitë e punësimit dhe do të inkurajojnë vetëpunësimin legjitim, aktivitete që do të ndërgjegjësojnë kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, me fokus të veçantë të rinjtë dhe të rejat e familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike dhe të rinjtë dhe të rejat e papunësuar apo me arsim të ulët, si edhe aktivitete që motivojnë, promovojnë dhe mbështesin kultivimin e bimëve aromatike mjekësore.

Objektivat e Projektit

Objektivat e projektit janë:

- Mbështetja e procesit të grumbullimit të BMA-ve dhe më tej të përpunimit të produkte kozmetike, si një alternative ekonomike dhe qëndrueshme kundër kultivimit të kanabisit, duke u fokusuar në angazhimin e të rinjve dhe grave fermere e familjeve të tyre, kryesisht atyre që jetojnë me ndihmë ekonomike;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik kundër kultivimit të kanabisit, me vëmendje të veçantë të fshatrat e prekura nga kultivimi i kanabisit, të rinjtë dhe të rejat e familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike, si dhe të rinjtë dhe të rejat e papunë apo me arsim të ulët.

Produktet

- Dizejnim i identitetit vizual dhe marketingut të produkteve kozmetike;
- Rikonstruksioni i objektit për t'a kthyer në qendër multifunkionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit mes bashkive dhe fermerëve të përzgjedhur;
- Blerja e dhomës tharëse dhe mjeteve laboratorike për prodhimin e produkteve kozmetike artizanale nga bimët;
- Ngritja e dy parcelave për të shërbyer si herbarium në funksion të zhvillimit të trajnimeve dhe rehabilitimi i zonës përreth;
- Hartimi i një plani biznesi për krijimin e shoqatës së përbashkët të fermerëve;
- Krijimi i një libërthi me histori suksesi.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (PZHRSH)

PARTNERËT:

- Bashkia Gjirokastrë
- Bashkia Dropull
- Instituti i Kërkimeve Urbane (URI)

KOHËZGJATJA:

01/02/2022 - 01/11/2022

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

